



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

**UDHËZUES PËR PROCESIN
ZGJEDHOR TË ZGJEDHJEVE TË
DATËS 21.6.2024 PËR AUTORITETET
DHE ORGANET DREJTUESE NË
UNIKO**



ZGJEDHJET NË UNIKO

ZGJEDHJET NË UNIKO ZHVILLOHEN MBI BAZËN E
RREGULLORES

*«PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET
DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIKO»*

ZGJEDHJET ZHVILLOHEN NË DATËN 21.4.2024

ORA 08:00-15:00



Komisioni i qendrës së votimit

Në rastin kur Njësia kryesore (Fakulteti) ka 1 qendër votimi-
KZF-ja do të luajë edhe rolin e KQV.

Vendndodhja e KZF-VE dhe vendit të numërimeve të votave
Selia e KZF-së ndodhet në godinën ku zhvillon aktivitetin
mësimor Njësia kryesore (Fakulteti).



FAKULTETI I BUJQËSISË
SALLA 227



**FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
DHE SHKENCAVE HUMANE**
SALLA 113



**FAKULTETI I
EKONOMISË**
BIBLIOTEKA KATI 1



SQARIM:

- **FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË**

SI PASOJË E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS DO TË KETË QENDRËN E SAJ TË VOTIMIT NË KATIN E PARË TË GODINËS SË FAKULTETIT TË BUJQËSISË SALLA 215.



DITA E ZGJEDHJEVE

VEPRIMET PARAPRAKE TË HAPJES SË KQV

- KZF, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, kryen këto detyra:
- a) vendos tryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve; "
- b) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
- c) afishon tabelat që ndalojnë përdorimin e çdo objekti që cenon fshehtësinë e votës;
- d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;
- e) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta, Në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emërtimi për autoritetin që do të votohet me ngjyrë të njëjtë me atë të fletës përkatëse të votimit.
- f) mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit për rektor para fillimit të procesit të votimit;
- g) sigurohet që ambientet zgjedhore të mos ketë persona dhe shenja që cenojnë parimin e paanshmërisë dhe drejtësisë në procesin zgjedhor.



LISTA PARAPRAKE E ZGJEDHËSVE

- Lista paraprake e zgjedhësve për personelin akademik të njësisë bazë hartohet nga strukturat e burimeve njerëzore, brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e ditës së zgjedhjeve. Lista e miratuar (brenda 24 orëve) nga përgjegjësi/i ngarkuari me detyrën e përgjegjësit, të njësisë bazë i dërgohet dekanit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit të njësisë kryesore, i cili e miraton listën përfundimtare dhe e shpall brenda jo më vonë se 2 (dy) ditëve.
- Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve. Gjatë një periudhe deri në 7 (shtatë) ditë pas shpalljes së listës paraprake, Sektori i Studimeve dhe Sektori TIK pranon kërkesat për korrigjime dhe realizon korrigjimin e kërkuar brenda 48 orëve dhe miratohet prej dekanit.



LISTA PËRFUNDIMTARE E ZGJEDHËSVE



- Lista përfundimtare miratohet nga dekani i njësisë kryesore. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentet është Sektori i studimeve dhe Sektori i TIK.
- 10 (dhjetë) ditë përpara ditës së zgjedhjeve, lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët nuk mund të korrigojë për asnjë arsye. Pas kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë mund t'i drejtohet me kërkesë KIZ-it. Ata mund të votojnë vetëm në rastin kur, pas shqyrtimit të kërkesës së tyre, KIZ-i vendos me vendim pozitiv lidhur me kërkesën për të marrë pjesë në zgjedhje.



SHENJAT QË DUHET TË PËRDOREN PËR VOTIM



SHENJA DUHET TË VENDOSSET **BRENDA KUTIZËS** QË TË SHPREHË
QARTË VULLNETIN E ZGJEDHËSIT



**NËSE SHENJA VENDOSSET JASHTË KUTIZËS OSE LIHET E
PAPLOTËSUAR, FLETA E VOTIMIT DO TË QUHET E PAVLEFSHME**



VOTIMI BËHET VETËM ME KARTË IDENTITETI OSE PASAPORTË



ÇDO ZGJEDHËS QË VOTON, HEDH FIRMËN NË LISTËN E TRUPËS ZGJEDHORE PËRKATËSE (NË KOLONËN PËRKATËSE) DHE EMRI I TIJ NËNVIZOHET ME THEKSUESIN ME NGJYRË TRANSPARENTE.



FLETËT E VOTIMIT QË DO TË PËRDOREN

Stafi akademik:

1. Fletëvotimi për rektor;
2. Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore; (Dekan)
3. Fletëvotimi për drejtues të njësisë bazë (Përgjegjës Departamenti)
4. Fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik;

Secila me ngjyra të ndryshme të vendosura dhe në faqen ballore të kutisë

Studentët :

1. Fletëvotimi për rektor;
2. Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;(Dekan)
3. Fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga studentët;

Secila me ngjyra të ndryshme të vendosura dhe në faqen ballore të kutisë




Fleta e votimit

Formati me një kandidat

NR	Emër	Atësi	Mbiemër
1	XNJSH	XJXJXJ	XNBXHXH

PRO


KUNDËR



NR	Emër	Atësi	Mbiemër
1	XNJSH	XJXJXJ	XNBXHXH

PRO

KUNDËR



Formati me më shumë se një një kandidat për:

- Rektor
- Dekan
- Përgjegjës departamenti

NR	EMËR	ATËSI	MBIEMËR
	XYZ	XYZ	XYZ
	XYZ	XYZ	XYZ
	XYZ	XYZ	XYZ
	XYZ	XYZ	XYZ
	XYZ	XYZ	XYZ
	XYZ	XYZ	XYZ

+

ZGJIDHET VETËM NJËRI NGA KANDIDATËT



Formati me më shumë se një një kandidat për anëtar Senati Akademik

Fakulteti i: Bujqësisë

Edukimit dhe Filologjisë

Ekonomisë

Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane


Do të konsiderohen të vlefshme fletët e votimit që kanë **maksimumi 3 zgjedhje**

NR	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	
	XYZ	XYZ	XYZ	
	XYZ	XYZ	XYZ	+
	XYZ	XYZ	XYZ	
	XYZ	XYZ	XYZ	
	XYZ	XYZ	XYZ	+
	XYZ	XYZ	XYZ	
	XYZ	XYZ	XYZ	+






Veprimet e KQV dhe KZF në fletën e votimit

KQV dhe KZF (në rastin kur luan rolin e KQV) kryen veprime me vulë **vetëm në pjesën e pasme** të fletës së votimit



PALOSJA E FLETËS SË VOTIMIT NË MËNYRË TË TILLË QË TË DALLOHEN VULAT NGA ANA E JASHTME





NË QENDRËN E VOTIMIT ËSHTË E NDALUAR PËRDORIMI I MJETEVE TË KOMUNIKIMIT APO REGJISTRIMIT NGA ANA E VOTUESVE

NËSE KAPEN VOTUES DUKE PËRDORUR MJETE KOMUNIKIMI APO REGJISTRIMI PËR TË FOTOGRAFUAR VOTËN E TYRE PËRVEÇ HEQJES TË SË DREJTËS PËR TË VOTUAR VOTUESI NDIQET PENALISHT SIPAS LIGJIT NË FUQI



NËSE KAPEN VOTUES DUKE PËRDORUR MJETE KOMUNIKIMI APO REGJISTRIMI PËR TË FOTOGRAFUAR VOTËN E TYRE FLETA E VOTIMIT VENDOSSET NGA KOMISIONI NË ZARFIN E FLETËVE TË VOTIMIT TË PAVLEFSHME



MATERIALET ZGJEDHORE

MATERIALET ZGJEDHORE PËR DITËN E VOTIMIT JEPEN ME PROCES VERBAL NGA **KIZ** TE **KZF** SIPAS FORMULARËVE TIP TË PËRGATITUR. HARTOHEN NË 2 KOPJE (**1 KOPJE KIZ DHE 1 KOPJE KZF**).

KZF-ja SHPËRNDAN MATERIALET PËR DITËN E VOTIMIT ME PROCES VERBAL TE **KQV-të** (NË RASTIN KUR KA TË TILLA), SIPAS FORMULARËVE TIP TË PËRGATITUR. HARTOHEN NË 2 KOPJE (**1 KOPJE KZF DHE 1 KOPJE KQV**).

NË PROCEDURAT E DITËS SË VOTIMIT NDIQEN PROCESVERBALET TIP PËR HAPJEN E VOTIMIT, **VULOSJEN ME KODE SIGURIE** TË KUTISË SË VOTIMIT, MBYLLJEN E VOTIMIT, **VENDOSJEN E SHIRITIT TË SIGURISË SË KUTIVE TË VOTIMIT**, KRYERJEN E PROCEDURAVE DHE NUMËRIMIN E FL. TË VOTIMIT.

NË PËRFUNDIM TË PROCESIT TË VOTIMIT, **KQV-të** DËRGOJNË NË **KZF-në** PËRKATËSE, KUTITË ME MATERIALET ZGJEDHORE SIPAS FORMULARËVE TIP DHE **KUTITË E VOTIMIT TË MBYLLURA ME SHIRITIN E SIGURISË**, PËR TË KRYER PROCEDURËN E NUMËRIMIT NGA **KZF-ja**.



PËR ÇDO PROCEDURË PËR HAPJEN E VOTIMIT, VULOSJEN E KUTIVE, MBYLLJEN E VOTIMIT, VENDOSJEN E SHIRITIT TË SIGURISË SË KUTISË E DERI NË NUMËRIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT, NUMRIN E PROCESVERBALEVE, VENDIN E TYRE, LËVIZJEN E ANËTARËVE NGA KOMISIONI, PARREGULLSITË E VËREJTURA ETJ. KQV/KZF-JA MBAN DETYRIMISHT PROCESVERBAL NË LIBRIN PËRKATËS NË PËRPUTHJE ME RREGULLOREN.

PERSONAT E PRANISHËM NË QENDRËN E VOTIMIT

- 1. ANËTARËT DHE SEKRETARI I KZF/KQV-SË;**
- 2. ZGJEDHËSIT QË JANË DUKE KRYER PROCEDURAT E VOTIMIT DERI NË PËRFUNDIM TË TYRE;**
- 3. VËZHGUESIT E AKREDITUAR NGA KIZ;**
- 4. PËRFAQËSUESIT E MAS-it (nëse ka).**

PERSONAT E PRANISHËM PAS MBYLLJES SË VOTIMIT

- 1. ANËTARËT DHE SEKRETARI I KZF/KQV-SË**
- 2. VËZHGUESIT E AKREDITUAR NGA KIZ**
- 3. KANDIDATËT**
- 4. PËRFAQËSUESIT E MAS-it.(nëse ka)**



Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

Votat për rektor, anëtarë të Senatit Akademik drejtues të njësisë kryesore (Dekan), drejtues të njësisë bazë vlerësohen dhe numërohen prej **KZF-së**.

KZF, pas numerimit të votave, plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ. (**formatet e tabelave do t'ju dërgohen nga KIZ**).

KQV-të kryejnë procedurat sipas modeleve tip të procesverbaleve dhe dorëzojnë kutitë e votimit të mbyllura pranë KZF-së për numërim.

Procedurat e numërimit të votave kryhen sipas radhës së përcaktuar:

- **Rektor;**
- **Drejtues i njësisë kryesore**
- **Drejtuesi i njësisë bazë**
- **Anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë)**



dhe formularëve tip të dërguar nga KIZ



VOTA TË PAVLEFSHME

Do të konsiderohen si vota të pavlefshme fletët e votimit kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ;**
- b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;**
- c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;**
- d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;**
- e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore të përcaktuara në fletën e votimit;**
- f) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;**
- g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.**
- h) KUR FLETA E VOTIMIT ËSHTË HEDHUR NË KUTINË E GABUAR.**



TABELA PËRFUNDIMTARE

Hartohet nga **KZF-ja** në përfundim të vlerësimit të numërimit të votave dhe shpall me vendim të veçantë rezultatet për çdo kategori. (**Modeli i përgatitur**).

Mënyra e përlogaritjes së votave bëhet sipas formulës përkatëse që përcakton **Neni 38, Pika 12 e rregullores**.

$$R \% = \frac{A}{N1} * 90\% + \frac{B}{N2} * 10\%$$

R% - është rezultati i shprehur në përqindje i një kandidati për një pozicion të caktuar;

A - është numri i votave pro kandidatit nga personeli akademik;

N1 - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga personeli akademik;

B - është numri i votave pro kandidatit nga studentët;

N2 - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga studentët.



KOMISIONI
INSTITUCIONAL
ZGJEDHOR
UNIKO QERSHOR
2024

